



AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/GJ8- 23 Prot.

Tiranë 29/04/2025

Nr. Dok. 202500009/23

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave përkatëse për hartimin e projektit teknik dhe kryerjen e një investimi bazë me qëllim përmirësimin e kushteve infrastrukturore në rrugën "Kolë Kamsi", Njësia Administrative nr. 2, Tiranë.

Drejtuar: BASHKISË TIRANË
Z. Kryetar

Tiranë

Për dijeni: Z. GJ.D

Tiranë

Të nderuar,

Sikurse jeni vënë në dijeni nga korrespondenca jonë zyrtare, pranë institucionit të Avokatit të Popullit ka depozituar një ankesë z. GJ.D ndaj Bashkisë së Tiranës, në të cilën parashtrohet ndër të tjera se, ai është banues në rrugën "Kol Kamsi" (tek vilat amerikane), në Tiranë. Shqetësimi i ngritur prej këtij shtetasi lidhet me faktin e bllokimit të rrugës "Kol Kamsi", për shkak të rrëshqitjes së dherave përgjatë muajve të parë të vitit 2021. Sikundër shkruan ankuesi edhe më parë ai së bashku me banorët e tjerë të lagjes

është ankuar lidhur me këtë problematikë, por edhe pse ka kaluar një kohe e gjatë, nga ana juaj (Bashkisë) nuk është gjetur ende zgjidhje, pasi sot e kësaj dite rruga vijon të jetë e bllokuar, e për pasojë aty nuk mund të hyjnë as makina e ambulancës dhe as ajo e zjarrfikësit.

Gjendur para kësaj situatë, ankuesi në muajin shtator të vitit 2022, ka kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit për shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj çështjeje dhe zgjidhjen e këtij problemi, me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të tij të ligjshme.

Pas rregjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore të formës dhe të përmbajtjes për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, respektivisht nenet 13, 17 shkronja "a" dhe 18 shkronja "b", ka vendosur ta pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes.

-I-

Qëndrimi i Bashkisë Tiranë, lidhur me rastin .

Për shqyrtimin me objektivitet të kësaj çështjeje dhe për të mundësuar një hetim të plotë administrativ, në vështrim të nenit 63, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: "*Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentat dhe informacionet e kërkuara prej tij*", si dhe në nenin 19, gërma "b" të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit" të ndryshuar, në të cilin parashikohet se : "*Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*", me tonën nr. K3/GJ8-2 prot., datë 29.09.2022, "kërkesë për shpjegime", i kemi kërkuar Bashkisë Tiranë, dhënien e shpjegimeve dhe të informacionit nëse qëndrojnë pretendimet e ankuesit si dhe mundësinë e zgjidhjes së problematikave të tij.

Me shkresën nr. 1912/1 prot., datë 10.10.2022, Bashkia Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe e Gjelbërimit, në përgjigje të shkresës sonë na ka informuar se, në zbatim të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", urdhrit nr.16365/1 prot., datë 29.04.2022, për "Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe të Gjelbërimit, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë", Vendimit nr. 16364/1 prot., datë 29.04.2022, për "Miratimin e Rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, në zbatim të detyrave funksionale DPPGJ ka kryer verifikimet me specialistët e saj, ku kanë konstatuar rrëshqitje të dherave në rrugën "Kolë Kamsi", Njësia Administrative nr. 2 Tiranë, ashtu

sikurse rezulton nga fotot që ka bërë pas verifikimit të gjendjes aktuale në terren në rrugën “Kolë Kamsi”, të cilat na i ka dërguar bashkëlidhur shkresës së mësipërme. Gjithashtu, kjo Drejtoria na ka informuar se nuk ka në detyrat funksionale të punës së saj ndërhyrjen për pastrimin dhe lirim të rrugëve nga dherat.

Në vijim të kësaj korrespondence lidhur me ndjekjen e rastit, ka rezultuar se me shkresën nr. 35923/1 prot., datë 24.10.2022, “Kërkesë për marrje masash”, të Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe të Ndriçimit Publik, (për dijeni Drejtorit të Kabinetit, të Bashkisë Tiranë si dhe Avokatit të Popullit). Kjo Drejtoria ka informuar gjithashtu se, referuar shkresës së ardhur pranë saj me nr. 35923 prot., datë 12.10.2022, në lidhje me “Rrëshqitjen e dherave”, në rrugën “Kolë Kamsi”, Njësia Administrative nr. 2, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, është kërkuar vlerësimi i problematikës së kërkesës në fjalë.

Në kushtet kur edhe pse kishte kaluar një afat i arsyeshëm kohor dhe nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe të Ndriçimit Publik, të Bashkisë Tiranë, nuk jemi informuar lidhur me vijimin e ndjekjes së rastit në fjalë, në kuadër të planit të hetimit, të kësaj çështje nga ana e Institucionit tonë, nëpërmjet të cilave iu jemi drejtuar me shkresat nr. K3/GJ8- 6 prot, datë 20.12.2022 dhe nr. K3/GJ8 -7 prot., datë 13.02.2023 dhe ju kemi kërkuar të na dërgoni një informacion sa më konkret dhe gjithëpërfshirës, lidhur me veprimet përkatëse të masave të marra nga ana juaj, sikurse sa sipër cituar edhe në shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike.

Me shkresën tuaj nr. 6663/1 prot., datë 22.02.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike, Drejtoria e Planifikimit të Punëve Publike, jemi vënë në dijeni se, rastin lidhur me ankesën e shtetasit GJ.D e ka kaluar për kompetencë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile.

Meqenëse sërish, nuk morëm sërish përgjigje lidhur me sa sipër, pavarësisht faktit se kishte kaluar një afat i arsyeshëm kohor, për nevojën të shqyrtimit të këtij rasti, iu jemi ridrejtuar me shkresat nr. K3/GJ8-10 prot., datë 28.04.2023 dhe nr. K3/GJ8-11 prot., datë 05.07.2023 dhe në kuadër të identifikimit sa më të saktë të problematikës, nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, iu kemi kërkuar në mënyrë eksplicite të na dërgoni një informacion sa më konkret dhe gjithëpërfshirës, si dhe dokumentacionin përkatës ligjor që ka të bëjë me çështjen e parashtruar sa sipër, si dhe një informacion lidhur me marrjen e masave nga ana juaj, ashtu sikurse kërkuar në shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike, Drejtoria e Planifikimit të Punëve Publike.

Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, me shkresën nr. 36813/1 prot., datë 07.11.2023, “kërkesë për bashkëpunim”, na ka vënë në dijeni se, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjellbërimit, pasi në mungesë të mjeteve dhe burimeve njerëzore nga ana e tyre, ka

kërkuar ngritjen e një grupi pune për të verifikuar gjendjen në vend dhe për të bërë të mundur largimin e dherave për ta bërë rrugën të aksesueshme.

Ndërsa me shkresën nr. 3625/1 prot., datë 24.11.2023, “Kthim përgjigje”, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik shprehet ndër të tjera se, gjatë periudhës Janar-shkurt 2022, të karakterizuara nga rreshje të mëdha shiu, ka konstatuar një numër të madh problematikash që konsistojnë në rrëshqitje aktive të skarpateve të sipërme, të trupit të rrugës dhe bllokimin në disa segmente të akseve kryesore rrugore. Bazuar në kapacitetet teknike dhe njerëzore që ka në dispozicion është bërë ndërhyrja në kohë reale për eliminimin e pjesës më të madhe të problematikave. Megjithatë, kanë konstatuar një numër problematikash, përfshirë këtu specifikisht edhe rrëshqitjen e rrugës: “Kol Kamsi”, zgjidhja e të cilave do të kërkonte një vlerësim të thelluar gjeologo-inxhinierik, kryerjen e projektit teknik dhe të një investimi bazë, gjë e cila i kapërcente kapacitetet dhe mundësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik. Në vijim, nga ana e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar është kryer studimi gjeologo-inxhinierik, i zonës së rrëshqitjes, i cili pas vlerësimit të shkaqeve dhe rrezikshmërisë aktuale kundrejt banesave që ndodhen në planin e rrëshqitjes në përfundim ka rekomanduar konkretisht:

- *Ndërhyrjen për rritjen e sigurisë, nëpërmjet marrjes së masave inxhinierike është e domosdoshme, në mënyrë që të vendoset ekuilibri në shpatet e prekura nga fenomeni gjeodinamik i tipit rrëshqitje.*
- *Një mënyrë ndërhyrje mund të jetë ndërtimi i mureve mbajtës të tipit “thurje me pilota”. Ndërtimi i këtyre lloj muresh apo çdo lloj tjetër ndërtimi, duhet të shoqërohet domosdoshmërisht me studime të thelluara ku të përfshihen:*
 - ❖ *Projektet konstruktive të aprovuara dhe të përpiluara nga specialistë të licensuar të fushës së ndërtimit*
 - ❖ *Studim i hollësishëm gjeologo-inxhinierik për çdo rast;*
- *Të mos lejohen ndërhyrje artificiale për sistemimin e terrenit apo për të krijuar tarracime, pa studime të mirëfillta.*

Në rrethanat e parashtruara sa sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik shprehet më tej se, çdo ndërhyrje nga ana e tyre për punime gërmimi në skarpatën e sipërme të rrugës për hapjen e trasesë së rrugës, do të ishte e rrezikshme sa i përket prishjes së stabilitetit të planit të rrëshqitjes, duke rrezikuar banesat në të dy anët e këtij segmenti rrugor. Në këto kushte për sistemimin përfundimtar të problematikës së konstatuar bazuar edhe në rekomandimet e studimit Gjeologo-Inxhinierik ata shprehen se është hartimi i projektit teknik të miratuar dhe kryerja e një investimi bazë.

Me qëllim zgjidhjen e problematikës së ngritur, Institucioni i Avokatit të Popullit, në vijim i është drejtuar me shkresën nr. K3/GJ8-15 prot., datë 20.12.2023, Bashkisë Tiranë (Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësisë Administrative dhe Emergjencave Civile, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik) dhe kemi kërkuar të na informoni sa më poshtë vijon:

- *A janë trajtuar dhe cilat kanë qenë përgjigjet lidhur me korrespondencën e mbajtur për trajtimin e rastit në fjalë, konkretisht shkresat e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nr.253 prot., datë 31.01.2022, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, me objekt: kërkesë për hartimin e projektit teknik për investim në rrugën “Kolë Kamsi”, Njësia Administrative Nr. 2 Tiranë, si dhe shkresa nr. 2914/1 prot., datë 21.10.2022, drejtuar Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Nëse po na dërgoni një kopje të tyre.*
- *Një informacion nëse është ngritur grupi i punës për të verifikuar gjendjen në vend dhe për të bërë të mundur largimin e dherave për ta bërë rrugën të aksesueshme, ashtu sikurse është kërkuar në shkresën nr. 36813/1 prot., datë 07.11.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile? Nëse po na sqaroni si paraqitet aktualisht situata dhe a është zgjidhur problematika e parashtruar sa sipër në rrugën “Kolë Kamsi”?*

Me shkresën nr. 36813/4 prot., datë 26.12.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, ka kthyer përgjigjen se, Drejtoria e Emergjencave Civile në pamundësi për kryerjen e hartimit të projektit ka përcjellë shkresën nr. 52213 prot., datë 31.12.2021, pranë Drejtorisë së Koordinimit me Donatorët për hartimin e një studim-projektimi për rrugën: “Kolë Kamsi”. Deri më tani nuk është mundur hartimi i një projekti në segmentin rrugor që përfshin banesën e z. GJ.D. Prandaj do ta ridërgojë përsëri për të qenë prioritet për vitin e ardhshëm.

Bëjmë me dije se lidhur me shkresën tonë nr. K3/GJ8-15 prot., datë 20.12.2023, na është kthyer përgjigje në aspektin formal vetëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, pavarësisht se i jemi drejtuar krahas saj edhe Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, (këta të fundit ende nuk kanë kthyer përgjigje edhe pse nuk konstatojmë ndonjë shkak të arsyeshëm ligjor), me qëllim që në koordinim të punës me njëra-tjetrën të na evidentonin jo vetëm problematikën lidhur me rastin në fjalë, por edhe masat e marra për zgjidhjen e saj.

Në analizë të përmbajtjes së përgjigjes së dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile evidentojmë faktin se në thelb ajo nuk ka hedhur dritë lidhur me sqarimin e pyetjeve të parashtruara nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit. Konkretisht nuk ka shpjeguar se, cilat janë veprimet që janë ndërmarrë pas shkresës nr. 253 prot., datë 31.01.2022, “Për vlerësimin e problematikës së kërkesës në fjalë”, e cila i është dërguar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, (shkresë kjo që i është dërguar njëkohësisht edhe Kabinetit), sepse në përgjigjen e saj i referohet një shkresë që daton kohë më parë me nr. 52213 prot., datë 31.12.2021). Gjithashtu nuk ka sqaruar nëse është

ngritur grupi i punës për të verifikuar gjendjen në vend dhe për të bërë të mundur largimin e dherave për ta bërë rrugën të aksesueshme ashtu sikurse është kërkuar në shkresën nr. 36813/1 prot., datë 07.11.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile dhe se si paraqitet gjendja aktualisht në rrugën “Kolë Kamsi”.

Ndërsa me shkresën nr. 540/1 prot., datë 21.02.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Drejtoria e Kullimit dhe e Rrugëve Rurale ndër të tjera ka informuar se, përgjatë viteve 2021 dhe 2022, në momentet kur rrëshqitja, si pasojë e shirave ka sjellë bllokimin total të rrugës ka marrë masat e nevojshme dhe ka kryer hapjen e rrugës nga dherat në mënyrë të kujdesshme duke ruajtur gjithnjë mosprekjen e masivit të rrëshkitur, por vetëm bërjen të kalueshme të kësaj rruge. Bashkëlidhur ka dërguar korrespondencën dhe studimin Gjeologo-Inxhinierik të hartuar nga Instituti Gjeologjik Shqiptar në të cilin përfshihen rekomandimet dhe masat që duhen marrë për trajtimin dhe zgjidhjen e kësaj problematike.

Në analizë të përmbajtjes së përgjigjeve të dërguara nga ana juaj, kemi konstatuar se nuk kemi marrë përgjigje për pyetjet e parashtruara nga ana jonë të cilat ne i kemi konsideruar të rëndësishme në kuadër të planit të hetimit administrativ, të rastit në fjalë. Në këtë kontekst, me qëllim jo vetëm të identifikimit sa më të saktë të problematikës konkrete në fjalë, por edhe të zgjidhjes së saj, ju kemi kërkuar me shkresa të përsëritura, të na dërgoni përgjigje në mënyrë eksplicite për secilën nga pyetjet e më poshtme të parashtruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit, si dhe të shoqëruara me dokumentacionin përkatës lidhur me rastin. Konkretisht;

- *Cilat janë veprimet që ka ndërmarrë pas shkresës nr. 253 prot., datë 31.01.2022, të dërguar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik (e cila i është dërguar njëkohësisht edhe kabinetit), sepse në përgjigje i referoheni një shkresë që daton kohë më parë me nr. 52213 prot., datë 31.12.2021);*
- *Nëse është ngritur grupi i punës për të verifikuar gjendjen në vend dhe për të bërë të mundur largimin e dherave për ta bërë rrugën të aksesueshme ashtu sikurse është kërkuar në shkresën Nr 36813/1 prot., datë 07.11.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile dhe se si paraqitet gjendja aktualisht?*
- *Deri më tani a është mundësuar hartimi i një projekti në segmentin rrugor që përfshin banesën e z. GJ.D?*
- *Cilat janë masat që keni ndërmarrë apo do të ndërmerni për zgjidhjen në mënyrë përfundimtare të kësaj problematike?*

Ju bëjmë më dije se deri më sot, nga ana e institucionit tuaj nuk na është kthyer ende përgjigje, edhe pse nuk konstatojmë ekzistencën e ndonjë shkaku ligjor i cili do të mund të justifikonte vonesën, apo mosdhënien e saj.

Vlerësimi i Avokatit të Popullit, konkluzione dhe rekomandime

Në nenin 108, pika 3, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është parashikuar se Bashkitë¹ janë njësi bazë e qeverisjes vendore. Ato kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisëse me përjashtim të atyre që me ligj u jepen njësi të tjera të qeverisjes vendore.

Bashkia duhet të luajë një rol sa më proaktiv, udhëhequr nga parimi i autonomisë vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ajo është e veshur me përgjegjësi efektive që mundësojnë një drejtim sa efikas, aq edhe afër qytetarit.

Për t'u rikthyer tek rasti objekt vlerësimi, sa i takon shqetësimit të ngritur nga shtetasi Gjon Dedndreaj, si një nga banorët e rrugës “Kolë Kamsi”, Njësia Administrative nr.2, Tiranë, Avokati i Popullit vlerëson se infrastruktura është një element me rëndësi kritike për zhvillimin dhe mirëqenien e një komuniteti.

Një ndër Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm² (SDG9), fokusohet në ndërtimin e infrastrukturës së përshtatshme, reziliente dhe inovative. Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës është thelbësor për rritjen e përgjithshme të mirëqenies dhe zhvillimit të qëndrueshëm të komunitetit të banorëve të rrugës “Kolë Kamsi”, Njësia Administrative nr. 2, Tiranë, duke e bërë kështu objektivin 9 një prioritet thelbësor në këtë rast.

Ky objektivi lidhet drejtpërdrejtë me përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme dhe sigurimin e mundësive të barabarta, ndaj dhe shqetësimi i ngritur lidhur me mungesën e infrastrukturës bazë, siç është bllokimi i rrugës, përfshihet drejtpërdrejt në fushën e objektivit 9. Përmbushja e këtyre nevojave përbën një rol kyç në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mirëqenies së këtij komuniteti pasi është lidhur ngushtësisht me aksesueshmërinë. Në rastin konkret, por jo vetëm, Avokati i Popullit identifikon disa aspekte thelbësore që e bëjnë infrastrukturën një prioritet kyç.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mbështeten në veprimtarinë e tyre të përditëshme pikërisht në konceptin e *autonomisë vendore*, të kuptuar si “... e drejta dhe aftësia e njësi të qeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë”, siç parashikohet në nenin 2, pika 2, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Në nenin 8, të këtij ligji “*Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor*” është parashikuar se, organet e njësi të vetëqeverisjes vendore mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor në territorin e juridiksionit të tyre për çdo çështje që nuk u ndalohej me ligj

¹ përfshirë këtu edhe atë Tiranë

² Objektivi nr 9 - Ndërtimi i një infrastrukture të fortë, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës e të qëndrueshëm dhe nxitja e movacionit.

ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj një organi tjetër shtetëror. Ato ushtrojnë kompetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhërave dhe urdhrave”.

Ndërsa në nenin 9 të tij, është parashikuar si një nga të drejtat dhe përgjegjësitë e Bashkisë edhe ajo e përcaktimit të masave që ajo i gjykon të nevojshme për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave.

Duke e trajtuar këtë çështje në një këndvështrim më specifik, evidentojmë se një ndër funksionet e **Bashkisë** në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në përputhje me përcaktimin e dhënë në nenin 23, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, është se: *“...bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për “Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore...”*

Në rastin konkret rezultoi se, pas konstatimit të rrëshqitjes së dherave në rrugën “Kolë Kamsi”, Njësia Administrative nr. 2 Tiranë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe e Gjelbërimit, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, në kushtet e bllokimit total të rrugës ka marrë masat e nevojshme dhe ka kryer hapjen e rrugës nga dherat në mënyrë të kujdesshme duke ruajtur gjithnjë mosprekjen e masivit të rrëshqitur, por aq sa për të mundësuar bërjen të kalueshme të kësaj rruge për kalimtarët.

Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik ndër të tjera është shprehur se, çdo ndërhyrje nga ana e tyre për punime gërmimi në skarpatën e sipërme të rrugës për hapjen e trasesë së rrugës, do të ishte e rrezikshme sa i përket prishjes së stabilitetit të planit të rrëshqitjes, duke rrezikuar banesat në të dy anët e këtij segmenti rrugor. Prandaj për sistemimin përfundimtar të problematikës së konstatuar bazuar edhe në rekomandimet e studimit Gjeologo-Inxhinierik është hartimi i projektit teknik të miratuar dhe kryerja e një investimi bazë. Për këto arsye me shkresën nr. 253 prot., datë 31.01.2022, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Pronësi Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile (për dijeni Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike) me kërkesë për hartim projekti teknik dhe investim në rrugën: “Kolë Kamsi”, Njësia Administrative nr 2, Tiranë. Meqenëse nuk ka patur reagim në vijim me shkresën nr. 35923 prot., datë 12.10.2022, ajo ka kërkuar vlerësimin e problematikës së kërkesës në fjalë nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, në lidhje me “rrëshqitjen e dherave” në rrugën “Kolë Kamsi”, si dhe për këtë situatë është vënë në dijeni edhe Drejtori i Kabinetit, të Bashkisë Tiranë.

Pavarësisht sa sipër, ka rezultuar se nga ana juaj nuk janë ndërmarrë veprime të mëtejshme lidhur me shkresën nr. 253 prot., datë 31.01.2022, të dërguar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik. Gjithashtu gjatë hetimit administrativ të rastit nuk rezultoi se nga ana juaj është ngritur një grup pune për të verifikuar gjendjen në vend dhe për të bërë të mundur largimin e dherave për ta bërë rrugën të aksesueshme, ashtu sikurse është kërkuar në shkresën nr.36813/1 prot., datë 07.11.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile.

Në këtë kontekst mbetet shqetësues fakti se pavarësisht se Bashkia Tiranë e pranon problematikën e ngritur, ajo nuk planifikon marrjen e masave konkrete për zgjidhjen e kësaj situate. Në këtë kuptim Bashkia nuk ka ushtruar kompetencat e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi për administrimin e rastit. Konkretisht deri më sot nuk është mundësuar hartimi i një projekti në segmentin rrugor që përfshin banesën e z. G.J.D i cili do ta zgjidhte në mënyrë përfundimtare rastin ashtu sikurse është referuar edhe në kërkesën sa sipër cituar, për hartim projekti teknik dhe investim në rrugën: “Kolë Kamsi”, Njësia Administrative nr. 2, Tiranë.

Në këto kushte vlerësojmë se kjo çështje e cila është nën përgjegjësinë tuaj, nuk është administruar si duhet si dhe në interes të komunitetit. Në ushtrim të funksionit tuaj nuk keni bërë planifikimin dhe financimin përkatës për zgjidhjen e kësaj problematike.

Në këtë këndvështrim, duam t’ju kujtojmë përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti Evropian, në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administratës publike, sipas të cilit: *“Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të”*.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit dëshiron të sjellë në vëmendjen tuaj, detyrimin për ushtrimin e detyrave funksionale dhe marrjen e masave të menjëhershme për zgjidhjen afatgjatë të problemit të infrastrukturës së rrugës “Kolë Kamsi”, Njësia Administrative nr. 2, Tiranë, në përputhje me standardet e kërkuara dhe si një nevojë emergjente për jetesën e këtij komuniteti.

Në këtë kuadër, duke patur parasysh se kjo është një çështje e rëndësishme për komunitetin, Avokati i Popullit konstaton se është thelbësore ndërmarrja e veprimeve konkrete për zgjidhjen e situatës së krijuar. Avokati i Popullit vlerëson se, për të adresuar problematikën e evidentuar dhe për të kontribuar në përmirësimin e qasjes, aq më tepër institucionet e pushtetit vendor, duhet të garantojnë standardet më të larta për qeverisje në nivel sa më afër qytetarëve. Investimet në infrastrukturë duhet të shoqërohen me angazhim të komunitetit dhe transparencë në procesin e planifikimit dhe zbatimit të projekteve. Përfshirja e banorëve është kyçe për sigurimin e mbështetjes dhe suksesit të projekteve. Bashkia Tirane ka përgjegjësi të rëndësishme për të siguruar që investimet në infrastrukturë të jenë efektive dhe të përshtaten me nevojat reale të komunitetit. Është e rëndësishme që Bashkia të vazhdojë të koordinojë përpjekjet e saj për të siguruar investime të përshtatshme dhe për të përmirësuar jetën e përgjithshme të komunitetit, duke adresuar çështjet e ngritura nga banorët në mënyrë efikase dhe transparente.

Evidentojmë faktin se gjatë hetimit administrativ lidhur me rastin ka rezultuar se ka patur veprime apo mosveprime nga Bashkia Tiranë të cilat nuk kanë qenë në korrelacion me kryerjen e detyrave funksionale dhe në përputhje me kompetencat e këtij organi, sikurse janë të përcaktuara me ligj, me akt nënligjor, si dhe veprimet administrative të nxjerra në zbatim të tyre, ushtrimi i të cilave është i detyrueshëm³ për të.

³ Neni 22, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Administrative.

Në vijim të analizës sonë, theksojmë se, në kuadër të bashkëpunimit gjatë procesit të zhvillimit të hetimit administrativ, evidentojmë faktin se gjatë komunikimit institucional me Bashkinë Tiranë, ka rezultuar se edhe pse janë kthyer përgjigje në aspektin formal lidhur me kërkesat për shpjegime apo informacion të dërguara nga Avokati i Popullit, në vlerësimin tonë ato nuk mund të konsiderohen të tilla në aspektin substancial. Kështu në përgjigjet e dhëna nga Bashkia Tiranë, ka rezultuar se në mënyrë të përsëritur, nga drejtoritë e ndryshme të saj nuk janë kthyer përgjigje çështjeve të specifikuara për informacion nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të cilat kanë rëndësi për zgjidhjen e drejtë të çështjes.

Duke e konsideruar refuzues qëndrimin e mbajtur prej Bashkisë Tiranë në më shumë se në një rast, çojmë se ky qëndrim ka cenuar një ndër parimet më të rëndësishme, parimin e bashkëpunimit ndërmjet organeve të administratës publike.

Parimi i bashkëpunimit ndërmjet organeve të administratës publike, është sanksionuar si në parimet e Kodit të Proçedurës Administrative, ashtu edhe në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore”. Neni 3, i këtij ligji parashikon se: *1. Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, efijencës dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucioneve pavarura, për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar, në përputhje me ligjin”.*

Në këtë kontekst, sqarojmë se, bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes. Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

Mungesa e informacionit dhe e dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme, apo tej afatit të përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu minon besimin e qytetarëve tek shteti i së drejtës dhe administrata shtetërore ndërkohë që të gjitha përpjekjet në nivel evropian por edhe të Këshillit të Evropës janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikator.

Besimi që ka qytetari në situatën e favorshme ligjore paraqitet i rëndësishëm jo vetëm për t’u mbrojtur nga normat dhe parimet kushtetuese por edhe nga veprimtaria e administratës gjatë veprimtarisë së saj, e cila duhet të garantojë ligjshmërinë e veprimeve që shteti kryen

me qytetarët e tij, sigurinë juridike se qytetari është objekt i veprimeve të ligjshme dhe se institucionet shtetërore do i garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të tij.

Gjatë trajtimit të rastit kemi konstatuar ekzistencën e një burokracie, e manifestuar kjo në mungesën e funksionimit të Administratës së Bashkisë si një e tërë. Ky qëndrim bie ndesh edhe me nenin 12 të rregullores së Bashkisë Tiranë *“Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e Administratës së Bashkisë Tiranë”*, ku ndër të tjera është parashikuar se: *“Për realizimin e shpejtë, të saktë dhe me kompetencë të funksioneve të bashkisë, të gjitha strukturat e administratës së bashkisë bashkëveprojnë dhe bashkëpunojnë me njëra tjetrën”*.

Në këtë këndvështrim vlerësojmë se, për qytetarin është e parëndësishme se cila drejtori e ka kompetencën për të zgjidhur problematikën e ngritur prej tij. Kjo gjë duhet të vijojë të bëhet nga vetë strukturat e Bashkisë duke e trajtuar kërkesën me kujdes, por edhe duke njoftuar qytetarin për dhënien e opsioneve afatshkurtra/afatgjata.

Në rrethanat sa sipër cituar, evidentohet lehtësisht se është neglizhenca/ mungesa e bashkëpunimit midis strukturave të Institucionit tuaj, e cila ka sjellë si pasojë që për rreth dy vjet e gjysëm kjo çështje nuk ka marrë ende zgjidhjen e duhur ligjore nga ana juaj. Në këtë këndvështrim, duam t’iu kujtojmë përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti Europian, në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administratës publike, sipas të cilit: *“Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të”*.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 63, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”*, si dhe nenin 21, shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se : *“ Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit kryen këto veprime ..., b) paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, c) Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*;

REKOMANDOJMË:

- Analizimin e këtij rasti në ushtrim të plotë dhe efektiv të funksioneve dhe kompetencave të Bashkisë Tiranë si dhe marrjen e masave përkatëse për hartimin e projektit teknik dhe kryerjen e një investimi bazë (sikurse rekomanduar edhe në studimin Gjeologo-Inxhinierik të hartuar nga Instituti Gjeologjik Shqiptar) me qëllim përmirësimin e kushteve infrastrukturore në rrugën: “Kolë Kamsi”, Njësia

Administrative nr. 2, Tiranë, në kuadër të përmirësimit të jetesës së banorëve të këtij komuniteti në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.

- Marrjen e masave përkatëse për të adresuar mungesën e komunikimit korrekt me institucionin e Avokatit të Popullit sa i përket kërkesave për informacion, në lidhje me të cilat përgjigjet kanë rezultuar me përmbajtje të paplota në disa aspekte, me qëllim që kjo situatë të mos përsëritet në të ardhmen.
- Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat përkatëse për bashkëpunimin, bashkërendimin dhe bashkëveprimin e punës në institucionin që ju drejtoni me qëllim mospërsëritjen e këtyre shkeljeve në të ardhmen.

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “ Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, brenda 30 ditësh nga marrja e këtij rekomandimi, lutemi të na vini në dijeni mbi qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi si dhe masat e marra për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

KOMISIONERE

ERINDA MELI

d.v